



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

---

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

Mbi përfitim e kontrollit nëpërmjet shit-blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Euro Investment Group Sh.p.k, nga shoqëria Euroteorema Group Sh.p.k tek shoqëria Euronuovo Sh.p.k

Në datën 16 Nëntor 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë marrëveshjes për shitblerje kuotash, të nënshkruar ndërmjet palëve Euroteorema Group Sh.p.k dhe Euronuovo Sh.p.k më datë 26 Tetor 2011, me objekt përfitim e kontrollit të shoqërisë Euro Investment Group Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave nga shoqëria Euroteorema Group Sh.p.k tek shoqëria Euronuovo Sh.p.k.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- **Euronuovo Sh.p.k** (blerësi): ushtron veprimtari në fushën e importimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore dhe pijeve në tregun shqiptar.
- **Euro Investment Group Sh.p.k** (shoqëria target): ushtron veprimtarinë e saj në fushën ndërtimeve Shqipëri.
- **Euroteorema Group Sh.p.k** (shitësi): ushtron veprimtarinë e saj në fushën e ndërtimeve si dhe shërbimeve në sektorin e pasurive të paluajtshme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**